



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim ekonomik (OECD) për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar për erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe bankës Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Reme Lala, Ditmir Bushati, Ervin Bushati, Elona Hoxha, Eglantina Gjermani, Ligoraq Karamelo, Evis Kushi, Andrea Marto, Alket Hyseni, Adnor Shameti dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Vasilika Hysi dhe Ralf Gjoni.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Niko Lera – Drejtor i Politikave Fiskale në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Ilir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi – Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilda Malile – Drejtoreshë pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Brikena Nastini – Specialiste në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim ekonomik (OECD) për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar për erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”, për të cilin relatore është zonja Gjermani, ndërsa si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe bankës Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”, ku relatore është zonja Elona Gjebrea.

Të pranishëm për prezantimin e projektligjit të parë kemi zotin Elton Haxhi, zëvendësministër për Financat dhe Ekonominë, dhe shokun tim të bankës së shkollës, zotin Niko Lera, drejtor në të njëjtën ministri. Mirë se vini!

Për projektligjin e dytë kemi: zotin Bejtja, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, zotin Enea Karakaçi, drejtor, zonjën Malile, drejtoreshë në OSHEE, e cila është kurdoherë e mirëseardhur, si dhe zonjën Nastini, specialiste në ministri. Mirë se vini!

Ju lutem, zoti Haxhi, një prezantimin shterues lidhur me projektligjin.

Fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Përshëndetje të gjithëve!

Në marrëveshjen e parë të ardhur para jush bëhet fjalë për përfshirjen e Shqipërisë në një nismë të OECD-së lidhur me shmangiet tatimore. Më konkretisht, kjo nismë përmban 15 masa, të cilat janë përcaktuar në dokumentin që ju keni përpara. Disa nga masat janë standarde minimale, të cilat duhen respektuar, ndërkohë që disa masa të tjera janë më të avancuara, për të cilat vendosin vetë shtetet nëse do t'i zbatojnë ose jo.

Në shtator të vitit 2013 grupi “G20” ka miratuar këtë nismë, e cila, shkurtimisht, quhet BEPS dhe zbatohet me koordinimin e OECD-së. Ajo synon tre objektiva kryesorë: përforcimin e koherencës së rregullave të tatimit mbi të ardhurat e korporatave, lidhjen e tatimit me përmbajtjen e aktivitetit dhe përmirësimin e transparencës.

Në vitin 2016 ne kemi marrë një ftesë nga sekretari i Përgjithshëm i OECD-së, zoti Guria, për t'u bërë pjesë e kësaj nisme dhe ftesa është përsëritur më 27 mars të vitit 2018. Kemi qenë duke përgatitur të gjithë procesin e pjesëmarrjes në këtë nismë. Parimisht kemi qenë dakord, por për arsye procedurash nuk kemi mundur t'i kthejmë përgjigje ende, sepse jemi në varësi të vendimmarrjes së parlamentit. Pas kësaj të fundit, do të komunikohet menjëherë me sekretarin e Përgjithshëm të OECD-së për pranimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në këtë nismë.

Njëra nga masat, për koincidencë, sapo është nënshkruar. Unë isha të martën në Paris, ku u nënshkrua marrëveshja për konventën multilaterale, e cila është njëra nga masat që parashikohet në këtë iniciativë të BEPS-it, pasi ishte një marrëveshje, e cila mund të nënshkruhej edhe pa qenë pjesë e tij.

Ministria e Financave mendon që kjo marrëveshje është e rëndësishme edhe në kuadër të integritetit të Shqipërisë, pasi është parashikuar dhe është dhënë angazhimi i Shqipërisë që do të jetë pjesë e kësaj marrëveshjeje brenda vitit 2019, duke e renditur Shqipërinë ndër vendet që kanë një bashkëpunim të mirë ndërkombëtar në fushën e tatim-taksave për shmangiet tatimore, të cilat, në përgjithësi, vijnë edhe si pasojë e mosbashkëpunimit me vendet e tjera.

Duke menduar se është një marrëveshje e rëndësishme, në qoftë se anëtarët e komisionit do të kenë pyetje, jemi të hapur t'u përgjigjemi në lidhje me detaje të këtyre nismave.

Mimi Kodheli – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua të përgëzoj qeverinë shqiptare për këtë marrëveshje.

Mendoj që, siç u tha edhe nga zëvendësministri, kjo marrëveshje vjen në përmbushje të angazhimit të Shqipërisë ndaj Komisionit Europian, se vendi ynë do të jetë pjesë e kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar BEPS në vitin 2019. Kështu që, sigurisht, në sajë edhe të angazhimeve që ne kemi, pa dyshim, do ta ftoja komisionin që të votonte pro ratifikimit të kësaj marrëveshjeje.

Mendoj që pjesëmarrja në kuadrin gjithëpërfshirës të këtij projekti ndërkombëtar u jep mundësi të gjitha vendeve, por edhe Shqipërisë, të punojë në mënyrë të barabartë në trajtimin e shmangies tatimore, të përmirësojë koherencën e rregullave të marrëveshjes tatimore, si dhe të sigurojë një ambient tatimor sa më transparent.

Duke jua kujtuar edhe një herë angazhimet që duhet të përmbushë Shqipëria ndaj Komisionit Europian, ju ftoj ta votojmë pro. Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja kolege!

Kam vetëm një pyetje. Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të kërkojë ndryshime ligjore në legjislacionin tonë, që lidhet me tatim-taksat?

Elton Haxhi – I hap rrugën një shqyrtimi të mëtejshëm. Pra, nuk vendosim se çfarë ndryshimesh do të bëjmë me nënshkrimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me asistencën e OECD-së ne do të rishikojmë...

Mimi Kodheli – Gjithsesi, ndoshta nuk sjell nevojën e ndryshimeve, por të rishikimit.

Elton Haxhi – Po. Përveç ndryshimeve ligjore, të cilat prekin aspektin fiskal, ka edhe nisma që janë shkëmbim informacioni. Pra, ne shkëmbejmë informacion me autoritetet e tjera tatimore qoftë për rezidentët tanë jashtë vendit, qoftë ata për rezidentët e tyre këtu.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Në qoftë se nuk ka pyetje ose diskutime, e hedhim në votim.

Kush është dakord në parim me ratifikimin e kësaj marrëveshjeje? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E bëjmë për procedurë.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Elton Haxhi – Faleminderit juve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Parlamentar për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 30.05.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe bankës Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Reme Lala, Ditmir Bushati, Ervin Bushati, Elona Hoxha, Eglantina Gjermani, Ligoraq Karamelo, Evis Kushi, Andrea Marto, Alket Hyseni, Adnor Shamenti dhe Vasil Sterjovski.

Mungojnë:

Rudina Hajdari, Vasilika Hysi dhe Ralf Gjoni.

Të ftuar:

Ilir Bejtja – Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi – Drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë në Infrastrukturë dhe Energji në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilda Malile – Drejtoreshë pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike

Brikena Nastini – Specialiste në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave

Mimi Kodheli – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë (huamarrësi), Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), sh.a. (agjencia zbatuese e projektit) dhe bankës Frankfurt am Main (KfW) për programin e investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I”.

Fjalën e ka zëvendësministri, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Do të jem shumë shterues.

Marrëveshjen e keni votuar një herë si marrëveshje kuadër, ndërkohë që kjo e sotmja është marrëveshja e huas, që lidhet direkt me livrimin e vlerës prej 30 milionë eurosh dhe grantit shoqërues prej 2 milionësh për përmirësimin e të gjithë rrjetit elektroenergetik në nivel shpërndarjeje, por edhe për sistemin automatik të komandimit të të gjithë rrjetit (SKADA).

Marrëveshja e ardhur vazhdon në kuadrin e projektit të parë për energjinë elektrike në Shqipëri, por mund të them se do të kemi edhe të tjerë.

(Deputeti Shameti ndërhyr pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka relatorja, nëse ka diçka për të shtuar, si referencë.

Elona Gjebrea – Kam vetëm një fjali për sa i përket rëndësisë që ka nga pikëpamja strategjike. Programi, për të cilin do të përdoret fondi dhe granti i parashikuar, do të ndikojë në përmirësimin e rrjetit shpërndarës të energjisë elektrike, në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, si dhe në rritjen e cilësisë dhe të sigurisë së furnizimit me energji elektrike për klientët në Shqipëri. Nga ana tjetër, duke pasur parasysh edhe historinë e suksesshme të bashkëpunimit me KfW-në, si një partner i besueshëm zhvillimi, i propozoj komisionit votimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Gjebrea!

Vijojmë me pyetjet nga kolegët.

Fjalën e ka deputeti Marto.

Andrea Marto – Faleminderit!

Unë kam një pyetje, por, ndoshta edhe kolegët e tjerë janë të interesuar: sa kushton modernizimi ose pasja e një rrjeti bashkëkohor të shpërndarjes së energjisë elektrike në Shqipëri? Për sa vjet do ta ketë Shqipëria këtë?

Ilir Bejtja – Deri tani, nisur nga të gjitha investimet që kemi bërë, por edhe me gjithë çfarë ishte bërë më përpara në linjën 20 kilovolt, ne kemi në standardet europiane të shpërndarjes së energjisë elektrike rreth 23% të rrjetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Me këto para?

Ilir Bejtja – Jo, flas në total. Deri tani kemi harxhuar rreth 300 milionë euro. Pra, i gjithë programi do të kushtonte mbi 900 milionë euro.

Mimi Kodheli – Rreth 1 miliard?

Ilir Bejtja – Po.

Andrea Marto – Për sa vjet do ta kemi?

Ilir Bejtja – Sipas mundësisë.

Adnor Shameti – 1 miliard me tonat?

Ilir Bejtja – Sipas mundësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe vite të vështira, siç kanë qenë në dy vjetët e fundit, ku investimet kanë qenë të kufizuara edhe për shkak të vulnerabilitetit që ne kemi për blerjen e energjisë. Na vjen e gjitha nga reshjet.

Kur të kemi, të investojmë edhe për termocentralet, që të kemi edhe burime alternative. Ndoshta kur të rriten edhe kapacitetet eolike dhe solare, do të kemi më tepër siguri, do t'i rrisim edhe më shumë investimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ritmet që kemi, ju keni miratuar një program, që quhet plani i konsolidimit të sektorit, i cili parashikon 7,75 miliardë lekë çdo vit investime në shpërndarje, që, në harkun e tre-katër vjetëve, shkojnë rreth 23 miliardë lekë.

Kjo do të thotë që, të paktën, gjysmën do ta kemi të rikuperuar, të kuptohemi, gjysmën e rrjetit të shpërndarjes. Duhet të kemi parasysh që ka nevojë për nënstacione, për kabina, për pastrim dhe investim, për tension shumë të ulët. Rrjeti i shpërndarjes së tensionit të ulët te ne është pothuajse i gjithi ajror.

Kohët e fundit kemi investuar rreth 5 miliardë lekë në linjën e tensionit të ulët (ABC) dhe kemi arritur në një pikë ku humbjet ulen me investime. Pra, duhet të modernizosh rrjetin e shpërndarjes që të shmangësh ndërhyrjet qoftë financiare, qoftë teknike.

Ka shembuj. Një projekt i tillë i plotë, si “110, 20, 04”, është bërë në Qytetin Studenti që në vitin 2015 me rreth 500 mijë euro, 12 kabina për rreth 2600 konsumatorë, ku ne kemi pasur 36% humbje, sot janë 3,7%, ndërkohë që humbjet mesatare vjetore i kemi në 24%. Ky është *gap*-i që kemi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kabina në të gjithë Shqipërinë ose, më mirë të themi, fidra, janë rreth 1200. Mendoni sikur ne t’i ndryshonim ose t’i modernizonim të gjithë fidrat, pa shkuar në nënstacione, do të shkonte në vlerën 600 milionë euro.

Kaq është totali i investimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasil Sterjovski – Kam një pyetje, ndoshta është jashtë rendit të ditës, por dua ta ngre si problem meqenëse i pranishëm është zëvendësministri.

Vetë jam nga Bashkia e Pustecit, nga zona e Prespës, dhe njihemi bashkë.

Si çështje e ngrita edhe seancën e mëparshme: linja kryesore furnizuese nga Bilishti në Pustec është tejet e amortizuar dhe tensioni është shumë i ulët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përveçse bashki, Pusteci është edhe zonë turistike, edhe park kombëtar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është edhe një fshat i projektit “100 fshatrat”, por edhe në dimër, edhe në behar është njësoj: ka ndërprerje të furnizimit me energji elektrike prej ditësh dhe tensioni që vjen është shumë i ulët, ku për rrjedhojë digjen shumë aparate elektroshtëpiake, plus edhe pompat e stacionit të ujit punojnë natën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk punojnë ditën për shkak të tensionit, pra nuk ka tension të lartë.

Nuk besoj që zona ime të jetë pjesë e ndonjë projekt-investimi. Prandaj, pyes: si mund ta bëjmë që atje të kemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Bejtja – Varet nga nënstacioni ku jeni të lidhur.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasil Sterjovski – Nga Zëmbllaku.

Ilir Bejtja – Zëmlaku është i fuqizuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë e keni vetëm linjë shpërndarjeje, asgjë tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zëmlakun e kemi 400 kilovolt, i fraksionuar në 110, por te ju duhet të jetë edhe linja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasil Sterjovski – Po nga Bilishti?

Ilir Bejtja – Nga Bilishti po ju them.

Linja duhet të jetë problemi. Megjithatë, duhet ta shikojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk mund t'ju them dot tani që nesër ose pasnesër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të sugjeroja që deputeti të na sillte një kërkesë me shkrim, por më saktë do të ishte të na e sillte kryetari i bashkisë, sepse ne kemi edhe një projekt tjetër “Smart Energy Municipality”, për të cilin atyre u ka shkuar ftesa që të futen në këtë sistem. Ky projekt parashikon edhe përmirësime në rrjet.

Mimi Kodheli – Kështu që mund të incentivohet.

Ilir Bejtja – Duhet të sjellin një shkresë, ku angazhohen për të marrë pjesë në projekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të sillni një *endorsement letter*.

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zoti Bushati.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ditmir Bushati – Dua thjesht të shpreh votën time pro kësaj marrëveshjeje dhe të komplimentoj, së pari, prezantimin e zëvendësministrit dhe, së dyti, punën e shkëlqyer që bën OSHEE-ja, administratori i Përgjithshëm, pavarësisht se sot kishte disa mungesa nga zonja Ilda Malile.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk më mbetet asgjë tjetër veçse ta mbështes këtë marrëveshje edhe pas prezantimit që relatorja bëri në mënyrën më konçize të mundshme.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Bushati!

Kam një pyetje për zëvendësministrin: a afektohet borxhi publik?

Ilir Bejtja – Jo, është i mbuluar me tavan.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi që në vitin 2016 që duam ta fusim brenda tavaneve.

(Zoti Bejtja flet pa mikrofon.)

Mimi Kodheli – Me mikrofon, ju lutem!

Ilir Bejtja – ...i marrëveshjes është parashikuar në tri lote: 10, 10, 10.

(Diskutime në sallë)

Mimi Kodheli – Ju lutem, ta dëgjojmë kolegun!

Ilir Bejtja – Pra, me gjithë PBA-në, efekti është që mesatarisht çdo vit të jetë 10 milionë euro. Është pothuajse sa një e shtata e *payback*-ut që kemi për borxhet e marra ndaj qeverisë shqiptare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, ne paguajmë çdo vit detyrime për 7,4 miliardë lekë dhe kemi marrë vetëm 1,3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çdo vit.

Mimi Kodheli – Keni marrë kaq pak, sepse nuk keni projekte gati, apo çfarë?

Ilir Bejtja – Jo, qeveria na ka nxjerrë nga sektorët prioritarë, ndaj tani duhet të paguajmë mbrapsht çfarë kemi marrë kur ishim sektor prioritar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Mendoj se tani mund ta kalojmë projektligjin në votim.

Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Faleminderit, të nderuar kolegë, për pjesëmarrjen!

E konsideroj mbledhjen të mbyllur.

Ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA